

VENDIM
Nr. 57, datë 22.2.2021

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SHPK
PËR VENDOSJE HIPOTEKE DHE BARRË SIGURUESE/PENG, NË FAVOR TË
BANKËS INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, MBI PASURITË E
PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME TË KRIJUARA APO QË DO TË KRIJOHEN
NGA SHOQËRIA KONCESIONARE “SEKA HYDROPOWER” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 20, pika “a”; të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 6, të nenit 7 dhe të nenit 8, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 21.7.2016; të pikës 1.3 dhe 1.6, të “Kushteve të licencës”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/7 prot., datë 22.2.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 244, datë 21.12.2020, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u vijua me njoftimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., me shkresën nr. 1329 prot., datë 3.12.2020, në të cilën iu bë me dije edhe detyrimi për plotësimin e dokumentacionit të munguar sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244/2020.

- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1260/1 prot., datë 28.12.2020 dhe nr. 353 prot., datë 12.2.2021, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Gjatë procedurës së shqyrtimit të këtij transferimi, në ERE ka mbërritur edhe shkresa e datës 23.1.2021, protokolluar në ERE me nr. 54 prot., datë 25.1.2021, e banorëve të fshatit Gjocaj, Njësia Administrative Derjan, pjesë e Bashkisë Mat, të cilët i janë drejtuar ERE-s me kërkesën për rishikim të vendimit nr. 244, datë 21.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k.

- Në lidhje me këtë kërkesë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 49, datë 17.2.2021, vendosi mospranimin e kërkesës së banorëve të fshatit Zall-Gjocaj, Njësia Administrative Derjan, pjesë e Bashkisë Mat, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 21.12.2020, si të pambështetur në prova.

- Referuar legjislacionit në fuqi, ERE shprehet me miratim vetëm për kërkesat e të licencuarve në lidhje me shitjen, dhënien me qira, transferimin, hipotekimin, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit, transmetimit, shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Nga analizimi i aplikimit të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në fazën finale, në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit” rezulton se dokumentacioni i aplikimit është tërësisht i plotësuar si më poshtë:

- neni 7, “Përbërja e kërkesës për transferim”, pika 1, geramat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”. Plotësuar;

- Subjektet koncesionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar, në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen (konkretisht neni 17, pika 1) për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA), në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve, i cili përmes shkresës me nr. 8580/1 prot., datë 22.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1260/1 prot., datë 28.12.2020, ka konfirmuar të drejtën e parashikuar në kontratën e lidhur mes palëve, për vendosje hipoteke dhe barre mbi asetet e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., të krijuara në zbatim të kësaj kontrate, për efekt të kredisë në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. Plotësuar;

- Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruara nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar. Plotësuar;

- Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mos bërjes publike të tyre. Plotësuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1260, datë 11.12.2020, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për autorizim për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k. ERE, në kuptim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 2, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, ka në kompetencë të tij vetëm miratimin e vendosjes së hipotekës dhe barrës sigurues/peng për pasuritë e paluajtshme/fikse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., mbi asetet fikse të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k., referuar nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti